



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit,
2. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.34/2017, “Për lirimimin e frekuencave të dixhital-dividentit”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Jorida Tabaku, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Xhevit Bushaj, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Edmond Spaho, Fatbardha Kadiu, Reme Lala, Pjerin Ndreu, Ismet Beqiraj dhe deputetë të tjerë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Dashamir Shehi, Agron Shehaj, Nadire Meçorapaj, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

1. Elton Haxhi – Zëvendësministër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë
2. Gentian Opre – Drejtor, Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor, Ministria e Financave dhe Ekonomisë
3. Gentian Sala - Kryetar, Autoriteti i Mediave Audiovizive
4. Dritan Xhelili - Drejtor Kabineti, Autoriteti i Mediave Audiovizive
5. Sara Xhumbari - Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Licencave, Autoriteti i Mediave Audiovizive

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

Në rendin e ditës sot është projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.34/2017, “Për lirimimin e frekuencave të dixhital-dividentit”, i paraqitur nga KM-ja.

Për të paraqitur projektligjin ndodhet në Komisionin e Ekonomisë zoti Elton Haxhi, Zëvendësministër në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe zoti Gentian Sala, kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Relator i komisionit për këtë projektligj është zoti Arben Pëllumbi.

Do të procedojmë me prezantimin e projektligjit nga zoti Elton Haxhi dhe nga drejtuesit e AMA-s dhe pastaj do të vijojmë me relatorin, pyetje –përgjigje, diskutime dhe natyrisht edhe shqyrtimi i projektligjit nën për nen.

Urdhëroni!

Jorida Tabaku – Zoti Braçe, në mbledhjen e fundit të Komisionit të Ekonomisë, por edhe në komisionet e tjera parlamentare, është diskutuar një çështje që besoj nuk është me interes vetëm për deputetët, por është me interes për të gjithë qytetarët shqiptarë dhe për opinionin publik. Bëhen pothuaj dy javë që PD-ja ka nxjerrë fakte, të cilat implikojnë drejtpërdrejt ministrin e Brendshëm për mbrojtjen dhe sigurimin e imunitetit për vëllanë e tij, zotin Agron Xhafaj, njëkohësisht ndjekur edhe nga një vendim i Gjykatës së Apelit në Itali për një dënim prej 7 vjetësh e dy muaj.

Në fakt, pasi mbaruam mbledhjen e komisionit, për herë të parë, maxhoranca mbajti një qëndrim dhe maxhoranca sigurisht qëndrimin e kishte në mbrojtje të ministrit dhe në mbrojtje edhe të të gjithë skandalit që ka pothuajse dy javë që i gjithë opinioni publik e ka të pamundur ta besojë.

Unë do të kisha dashur që këtu në Komisionin e Ekonomisë ne të diskutojmë se si mundet që një person, i cili ka një dënim nga Gjykata e Apelit në Itali hyn dhe del në Qendrën Kombëtare të Biznesit, regjistron biznese pa i hyrë një gjemb në këmbë. Si ka mundësi që një person, i cili ka një dënim të formës së prerë ekstradohet pa e parë askush, pa e dëgjuar askush, fshehtazi, ndërkohë që për 5-6 vjet ka qenë në aktivitet të plotë tregtar me biznesin e tij në zonën e Vlorës në menaxhim, jo vetëm të bizneseve të tij, por edhe të bizneseve të të tjerëve, ashtu siç thonë qytetarët e Vlorës.

Sot është 45-vjetori i Revoltës së Spaçit. Unë e di që është ironike dhe shumë deputetëve socialistë kjo datë nuk u thotë asgjë, por për ne kjo është shumë domethënëse, sepse ashtu si 45 vjet më parë, edhe sot drejt atij sistemi po shkojmë.

Në qoftë se kapim drejtësinë, në qoftë se kapim gjykatat, në qoftë se kapim prokurorinë, në qoftë se mbrojmë krimin, drogën, korrupsionin, nuk do të jetë e largët dita ku Shqipëria nuk do të ketë mundësi të avancojë në asnjë nga hapat e procesit të integritetit evropian.

Unë do të kisha dashur që ta merrnim shumë seriozisht prezantimin ligjit dhe falënderoj kolegët e Ministrisë së Financave që kanë ardhur këtu, po çfarë të marrim seriozisht? Këtu është për të qeshur e për të qarë. Diktuam në këtë komision taksën e pronës dhe PD-ja bëri propozime për zbatimin e taksës së pronës, ndërsa sot dëgjoj se Ministri i Financave kishte dalë në konferencë për shtyp dhe thoshte me të njëjtat argumente që PD-ja përdori këtu, zbatimin do ta fillojmë në janar të 2019-ës. Argumentet tona këtu nuk i besoi.

Këtu është për të qarë e për të qeshur, se kur ne diskutuam për tavanin e biznesit të vogël, për pagesën e TVSH-së, ju u tallët me propozimin e PD-së, kur ne thamë në 12 milionë duhet të fillojë tavanin për biznesin e vogël. Tani dëgjojmë qeverinë që merr *mot-a-mot* të njëjtin propozim, u shton edhe TVSH-në 20% bizneseve. Në fakt nuk dinë të kopjojnë as mirë se kopjojnë pothuajse përgjysmë, kopjojnë keq, si kopjacë të këqij që janë.

Do të kisha dashur shumë që ne këtu të diskutonim edhe për faktin se si ka mundësi që në 4 muajt e parë të vitit 2018 në Shqipëri ka pothuaj 460 milionë euro më shumë të këmbyera, sipas të dhënave të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Këto janë paratë e krimit dhe të drogës.

Si ka mundësi, se është një pyetje që unë ia kisha bërë edhe guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, por nuk ishim këtu për t'i diskutuar; si ka mundësi që numri i lejeve të ndërtimit në qytetin e Tiranës është rritur me 231 dhe kjo nuk shoqërohet me kredi nga sektori bankar? Këto janë para të krimit dhe të drogës që po hidhen në ekonomi.

Ne këtu mund të vijmë dhe të diskutojmë shumë fakte dhe shumë argumente, por këtë qeveri nuk e merr dot seriozisht kush, çfarë thotë dhe e ndryshon sot, kur i ofron mbrojtje krimit, kur i ofron mbrojtje ministrit të Brendshëm pas gjithë atyre që kanë ndodhur dhe pas vendimit që pritet për në qershor.

Shqipëria nuk e ka luksin të humbë edhe një herë tjetër mundësinë për hapjen e negociatave. Qeveria duhej të kishte bërë çdo gjë që kjo të ndodhte në qershor, por çdo ditë

që kalon na mbush mendjen se ky është interesi i fundit i qeverisë, sepse interes parësor ajo ka sigurisht mbajtjen e pushtetit, mbrojtjen e pushtetit dhe çdo gjë vetëm për hir të pushtetit.

Unë, zoti Braçe, kërkoj që në këtë mbledhje të Komisionit të Ekonomisë, për herë të parë, të dëgjojmë nga persona me integritet nga maxhoranca, siç janë shumica deputetëve socialistë këtu, që njëherë e mirë duhet të ndahemi nga kjo rrugë që po na ndalon edhe të ardhmen tonë europiane.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Tabaku!

Së pari, për etikë të këtij komisioni unë besoj se nuk është në tagrin tuaj, as keni ju mundësinë që të ndani kolegët deputetë që keni përballë në njerëz me integritet dhe njerëz pa integritet.

Është një problem i madh kjo histori, ju e merrni përsipër dhe meqë më kujtuat Revoltën e Spaçit, po, në atë regjimin e Revoltës së Spaçit, pa asnjë lloj diskutimi që bëhej edhe kjo punë, dilte organizata e Frontit dhe ndante në lagje se kush ishte me integritet dhe kush ishte pa integritet.

... po patjetër, me gjyq popullor, njësoj si ky që po bëni këtu prej disa seancash. Pastaj i ndante se kush kishte integritet dhe kush jo. Unë mendoj se para kolegëve duhet të jeni përballë, që të gjithë i keni këtu përballë, mirë është të ruani etikën. Normalisht, mos i bini në qafë askujt pa pasur fakte dhe prova.

Së dyti, unë vërtet prisja që të flisnim për ligjin “Për lojërat e fatit”, siç e kërkuat herën e kaluar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe unë kam ardhur shumë i përgatitur për atë ligj, por do të doja të kishit bërë minimumin e gjësë, të kishit sjellë një kërkesë me shkrim, me qëllim që të kishim organizuar një seancë në prezencë edhe të ministrit, edhe të drejtuesit të lojërave të fatit dhe secilit prej kolegëve deputetë që janë këtu, për t’u dhënë mundësi të gjithëve të flisni për një çështje konkrete të rëndësishme, që ka të bëjë me një problem që për mua është madhor, siç është problemi i kumarit, i bixhozit, i basteve, i lojtarëve të të gjithë këtyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

E nisët me një çështje që keni 2 javë që e mbani. Në fakt, keni që në vitin 2002 që e keni në axhendën tuaj, e flisni, e përfllisni, e harroni, e rimerrni, vini në pushtet nuk bëni asgjë, ktheheni përsëri, ikni, dilni në opozitë e riktheni, vini përsëri në pushtet nuk bëni asgjë, keni një ministër tuajin 6 muaj dhe nuk bën absolutisht asgjë, pastaj e riktheni përsëri

dhe vazhdon kjo histori të zgjatet pa fund. Unë mendoj se kjo histori e ka një fund dhe rruga më e mirë e mundshme është ajo që është konsumuar.

Sot deputetët tuaj, që kanë denoncuar kanë bërë dëshmitarin në organin e prokurorisë. Të tjerë njerëz që thonë se kanë lidhje me këtë ngjarje po bëjnë përsëri dëshmitarin në institucionin e prokurorisë. Siç e dini, Prokuroria e Krimeve të Rënda është një institucion serioz në referencë të vlerësimit që ka bërë edhe opozita në këtë vend. Pra, mirë është që kjo çështje të zgjidhet gjyqësisht dhe të zgjidhet me ato institucione tek të cilat edhe ju keni shprehur besimin tuaj të palëkundur. Të vazhdojmë të merremi me një gjyq politik në sallën e Kuvendit dhe të bëjmë një gjyq popullor jashtë sallës së Kuvendit nuk ia vlen. Jemi në një shtet, kemi hyrë në një sistem ku ligji dhe zbatimi i tij është parësor, themelor. Unë besoj se nuk ka rrugë më të mirë sesa rruga gjyqësore për ta ndjekur këtë çështje deri në fund.

Për çështjet e tjera, zonja Tabaku, ju kam thënë edhe herë të tjera se kur u referoheni fakteve, duhet t'u referoheni në mënyrë të plotë. Të thoni të vërtetën deri në fund dhe jo gjysmën e saj. Është e vërtetë, po, në janar të këtij viti janë 460 milionë dollarë më shumë, por më shumë sesa janari i vitit 2014.

Më lejoni të them se jemi 4 vjet më pas dhe pa asnjë lloj diskutimi që fluksi i valutës, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë për shkak të zhvillimeve ekonomike, për shkak të eksporteve, për shkak të turizmit dhe për shkak të një serie aktiviteteve, ku qartazi fare...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është problemi juaj. Unë nuk ju pengoj të vazhdoni të shpenzoni më shumë dhe të mendoni se paratë që keni në xhep dhe i shpenzoni vijnë nga droga.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur nuk e bëni dot këtë për vete, ju lutem shumë kursejini akuza të tilla për qytetarët, të cilët janë pjesë e këtyre aktiviteteve ekonomike! Apo në rast se keni emra të tjerë që merren me aktivitete kriminale, pa asnjë lloj diskutimi t'u drejtoheni organeve, agjencive ligjzbatuese të shtetit. Por të vini këtu dhe t'i mohoni këtij vendi, t'i kërkonin këtij vendi që të ketë flukse valute aq sa kishte 4 vjet më parë, të paktën është *nonsens* ekonomik. Patjetër që është *nonsens* ekonomik dhe natyrisht ligjor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Noka, ju keni qenë ministër i Brendshëm. Ju e dini shumë mirë që në këtë histori, kur flasim për aktivitete kriminale duhet të flasim me prova. Pa asnjë lloj diskutimi, që ju keni mendimin tuaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Noka!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, e doni fjalën? Të mbaroj dhe flisni ju.

Zoti Spaho, edhe një herë, unë jam gati t'ju dëgjoj pa asnjë lloj problemi. Në rast se e doni fjalën, jua jap fjalën të flisni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj fjalën dhe ta jap fjalën ty. Çfarë problemi keni tani?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja m'u drejtua mua.

Zoti Noka, unë jam drejtues komisioni dhe jo emisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse nënkryetarja e këtij komisioni më drejtohet mua, unë besoj se e kam të drejtën

...

Tani, e kishit me mua, apo me ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë, po thosha se t'i mohosh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam 7 herë që po të them.

T'i mohosh ekonomisë kombëtare flukse hyrje valute në 4 vjetët e fundit, natyrisht që është *nosnsens* ekonomik.

Pjesa tjetër pastaj pa asnjë lloj diskutimi, kush ka prova t'u drejtohet organeve të prokurorisë sa më parë që të jetë e mundur.

Zonja Tabaku ju dëgjova për të disatën herë që flisni për leje ndërtimi të rritura me 212% e të tjerë me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

231 leje.

Për të disatën herë e dëgjoj këtë argument dhe natyrisht që nuk marr nga ju asnjë lloj *feedback*-u më pas. Ju jeni e familjarizuar me zhvillimin e një prone dhe e dini fare mirë se marrja e lejes nuk përkon gjithmonë me fillimin e punës. Për shembull, unë jam i

familjarizuar me një leje të vitit 2008, natyrisht pas 10 vjetësh është bërë gati që të fillojë dhe të ndërtohet. Përsëri nuk e dimë nëse do të fillojë të ndërtohet apo jo. Ju e llogarisni te paratë e hashashit, të drogës e ku e di unë, të tjera më radhë që financojnë lejet e ndërtimit. Kjo është një histori që kërkon edhe dokumentacionin, edhe logjikën më pas, me qëllim që të konsumohet e gjitha ose si zhvillim normal i aktivitetit të ndërtimit në këtë qytet ose si zhvillim kriminal dhe pastaj dërgimin pranë organeve të prokurorisë, me qëllim që t'i jepet një zgjidhje përfundimtare edhe këtij projektvendimi që ka Partia Demokratike në vijim.

Jorida Tabaku – Edhe Departamenti i Shtetit.

Erion Braçe – Departamenti i Shtetit, për çfarë? Për lejen që po flas unë?

Jorida Tabaku – Zoti Braçe, Departamenti i Shtetit shkruante e zezë mbi të bardhë: “Ndërtimi dhe turizmi janë dy sektorët ku po pastrohen paratë.”

Erion Braçe – Patjetër. Pse, si mendoni ju?

Jorida Tabaku – Flasim duke u bazuar në raporte ndërkombëtare serioze.

Erion Braçe – Patjetër, nuk e diskutoj këtë pjesë, që Departamenti i Shtetit ka arritur në një konkluzion të tillë. Pa asnjë lloj diskutimi!

Aty ku ka raste të tilla, pa asnjë lloj problemi, mund të shkojnë dhe t'i orientojnë drejt organeve të prokurorisë. Unë, për shembull, për ato raste që di, do ta bëj. Kush i di rastet dhe nuk e bën, mirë është ta bëjë. Pastaj, kush është në dijeni të një fakti kriminal dhe nuk e zbardh, është histori tjetër, që lidhet me ligjin. Ndërkohë që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jorida Tabaku – ...të zbardhim këtë faktin kriminal për grupin e organizuar që drejtohet nga Agron Xhafaj. Çfarë po ndodh? Këtu e kishim diskutimin.

Erion Braçe – Në prokurori është, zonjë, në Prokurorinë për Krimet e Rënda.

Jorida Tabaku – Prandaj iku personi? Prandaj u zhduk?

Erion Braçe – Zonjë, personi nuk është zhdukur. Personi është në burg.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja tha se u zhduk.

Tani, o Flamur, mos më dëgjo vetëm mua, dëgjo edhe kolegen! Të lutem, tani!

Pra, edhe një herë, kjo është histori tjetër dhe nuk më intereson ta zgjas në këtë pikë.

Zonja Tabaku, ne ju dëgjojmë me shumë vëmendje. Ajo që është racionale në ato që thoni, ka mundësi që në këtë komision të jetë marrë parasysh, madje të jetë votuar, jo vetëm këtu, por edhe në seancën plenare nga propozimet tuaja.

Por më vjen keq, mbase jeni ngarkuar me këtë çështjen e dy javëve të fundit dhe nuk keni mundësi t'i ndiqni lajmet deri në fund!

Për taksën e pronës, pa asnjë lloj diskutimi, edhe kur është bërë debati për këtë çështje, është diskutuar që ky është një vit tansitor për aplikimin e taksës së pronës dhe cilat bashki do ta kenë mundësinë të aplikojnë për vulën e re të taksës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Spaho, më vjen keq! Unë nuk...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, mirë. E mbarova.

Pra, edhe një herë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Po si t'i lë? Kur i thoni ju, unë duhet vetëm t'i dëgjoj dhe të mos i përtyp fare!

Po thosha se, siç është parashikuar në ligj, ashtu do të zbatohet. Secila nga bashkitë që e ka mundësinë, pra këshillat bashkiakë që e kanë marrë vendimin për taksën e pronës, pa asnjë lloj diskutimi, do të zbatojë formulën e re. Bashkitë që kanë probleme me zbatimin e formulës së re, do të vazhdojnë me formulën e vjetër të taksës mbi ndërtesën. Ama, është një taksë që do të mblidhet nga të gjithë qytetarët me ato përjashtime që kemi vendosur: pensionistët, ata me ndihmë ekonomike dhe çdo kategori që ky komision ka vendosur të përjashtojë, kurse për biznesin e vogël, më vjen keq, nuk ju kopjojmë dot, as nga zero, as nga dhjetë, as nga tetë, as nga dymbëdhjetë! Pa asnjë lloj diskutimi, do të çlirohen nga tatimi mbi fitimin të gjitha bizneset me xhiro vjetore nga 8-14 milionë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, unë e kuptoj që ti nuk ke lidhje me biznesin e vogël. Mund të kesh me të mesmin ose në të madhin, por me biznesin e vogël jo.

Nga zero deri në 5 milionë do të jetë 0. Nga 5-14 milionë do të jetë 5 dhe mbi 14 milionë do të vazhdojë skema progresive.

Ne i qëndrojmë asaj që kemi thënë dhe do ta çojmë deri në fund këtë çështje, pavarësisht se çfarë mendoni ju. Ju keni sistemin tuaj. Shumë mirë, vazhdoni me tuajin. Ne kemi sistemin tonë, për atë jemi votuar. Do t'i mbajmë një për një angazhimet që kemi marrë përkundrejt këtyre kategorive, për të cilët po flasim. Për të tjerët, mendoni ju, sidomos për "të mëdhenjtë".

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në gjithë sa thatë, ju jap të drejtë t'ua drejtoheni organeve të prokurorisë për çdo pretendim që keni, lidhur me aktivitete kriminale në këtë vend.

Ama, nga ana tjetër, kur flasim për zhvillimet ekonomike, referojuni të vërtetave ashtu siç janë, të plota, jo me gjysma. Kjo është shumë e rëndësishme.

Këtu jemi në një komisioni përgjithësisht profesional dhe, normalisht, nuk na lejohej të operojmë me gjysmat e të vërtetave, për sa kohë flasim për ekonomi dhe financë. Për pjesën tjetër, thoni çfarë të doni, jeni në të drejtën tuaj!

Urdhëroni zonja Kadiu, zoti Spaho...

Zonja Kadiu.

Fatbardha Kadiu – Të nderuar kolegë,

Unë e kuptoj gjithë tendencën që ka kryetari i këtij komisioni për ta kthyer këtë në një komision normal, duke thënë se këtu jemi te Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, por unë dua t'ju them që para se të jemi anëtarë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, ne jemi ligjvënës, jemi anëtarë të Kuvendit të Shqipërisë dhe, mbi të gjitha, jemi rojtarët e zbatimit të ligjit, që do të thotë se në një situatë të tillë dramatike, ku ministri i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë, bashkë me vëllanë e tij, shkelin hapur ligjin, sigurisht që ne nuk mund të zhvillojmë një seancë normale.

Këtu e para tri dekadash, ish-hetuesi Xhafaj, pas vdekjes së babait të tij shpirtëror, masakroi të rinjtë duke u shkullur dhëmbët me darë, duke u vendosur edhe vezë të ziera nën sqetull, deri sa ata të rinj humbën jetën.

Vijnë sot, pas tri dekadash, oficerë policie të frymëzuar nga ky ish-hetues, mbështetës i dhunës, por që sot është në rolin e ministrit të Brendshëm, dhe kryejnë të njëjtën masakër me të riun e Korçës në ambientet e komisarariatit.

Kjo është një nga ato dhjetëra e qindra arsye pse ky ministër sot duhet të japë dorëheqjen. Madje, duhet të kishte dhënë dorëheqjen edhe për skandalin e madh që ndodhi para një jave.

A mundet dikush (megjithëse këto janë pyetje retorike) të thotë se si është e mundur që Agron Xhafaj, i dënuar me një vendim gjykatë të formës së prerë, me 7,2 vjet, nuk bën asnjë ditë të vetme burg?

Si është e mundur që ky Agron Xhafaj vazhdon trafikun e drogës deri në vitin 2017?!

Si është e mundur që ky Agron Xhafaj, në vend që të ekstradohet, kalon si turist në sportelet e kufirit të vendit tonë?!

Si është e mundur që ky Agron Xhafaj, në vend që të arrestohet nga institucionet e shtetit tonë, arrin të bëjë edhe një kallëzim penal për deputetët e Kuvendit?!

Kjo është situata ku ndodhemi jemi sot. Ky është gjithë realiteti i hidhur i vendit tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbaroj unë, zotëri!

Erion Braçe – Zoti Ndreu, mos ndërhyjni! Ju lutem! Patjetër, jua jap unë fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatbardha Kadiu – Ju duhet të kuptoni se i gjithë procesi i integritetit është peng i Kryeministrit tuaj dhe i dy ministrave trafikantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Zoti Ndreu, mos ndërhyjni!

Fatbardha Kadiu – E gjej me vend thirrjen e koleges sime kur thotë se të gjithë ata deputetë socialistë, ata kolegë socialistë, që nuk kanë lidhje me drogën, që nuk mbajnë parcela droge, që nuk kanë ndër mend të lidhen ndonjëherë me klanë droge, sot nuk mund të jenë në krah të Xhafajt. Sot nuk duhet të jeni në krah të ministrit. Sot duhet të bëheni palë me ne për të këmbëngulur që të heqim një herë e mirë këtë të keqe kaq të madhe që ka vendi ynë për të mirën e çdo qytetari që ju ka votuar ju apo ne.

Faleminderit!

Erion Braçe – Më falni, vetëm një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por avash, se e drejtoj unë mbledhjen!

Zonjë, mu duk sikur më vutë në faj që po kërkoj që kjo mbledhje të jetë normale. E kuptoni që nuk është faj të kërkoj që një mbledhje të jetë normale? Nuk është faj. Ju mund ta mendoni si të doni Shqipërinë, ka njerëz në këtë vend, që çohen në mëngjes, autosugestionohen dhe kujtojnë se jetojnë në një realitet komplet ndryshe nga ai që kanë në shtëpitë e tyre. Pa diskutim që janë në të drejtën e tyre të bëjnë si të duan, por të vish këtu e të më thuash se po bëj faj që po bëj një mbledhje normale, me vjen keq. Normaliteti në këtë vend nuk përcaktohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, zoti Noka, pa asnjë lloj diskutimi, se e drejtoj unë këtë komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo historia që vini nga komisione të tjera, doni të flisni dhe i thoni kryetarit të komisionit: “Ti në komisionin që drejton, nuk ke të drejtë të flasësh”, është e tepërt. Keni të

gjithë të drejtën të flisni, folët edhe mbledhjen që shkoi, por mos ia mohoni askujt të drejtën për të folur.

E dyta, zonjë, unë nuk jam këtu as për të bërë gjykatësin dhe as prokurorin, ju e keni të gjithë të drejtën ta bëni si gjykatësin ashtu dhe prokurorin. Bëjeni, por nuk i imponoheni dot këtij komisioni të menduarit tuaj! Unë jam mësuar që shkeljen e ligjit ta hetojë prokuroria dhe në fund fare e vendos gjykata nëse është me atë që bën prokuroria, apo tjetri vazhdon të jetë i pafajshëm deri në fund. Të vini këtu të thoni që ministri i Brendshëm ka shkelur ligjin, më mirë shkoni në prokurori, zonjë, dhe paditeni për atë shkelje ligji që ka bërë! Shko në prokurori dhe kallëzoje pa asnjë lloj diskutimi edhe për atë të kohës së Partisë së Punës, që thoni ju, edhe për atë tjetrën, ama duhet të keni sensin e ligjit! Se të thoni që ky tipi iku nga Shqipëria, kur shkoi në burg dhe merr kurajën të padisë deputetët e PD-së, pse çfarë jeni ju?! Keni ndonjë status? Po ne, mos kemi ndonjë status mbi qytetarët e Republikës së Shqipërisë?

Nuk funksionon kështu, zonja Tabaku. Të drejtën për të kallëzuar e ka cilido, madje edhe ai që është brenda në burg ka të drejtë të kallëzojë cilindo. Nuk ia mohoni dot askujt. Madje ka edhe një problem tjetër, që ne, me ligj, ata që kanë dijeni për kryerjen e një vepr penale, i ndjekim penalisht nëse nuk kallëzojnë krimin. Prandaj gjithkush ka të drejtën e Zotit dhe të Kushtetutës të kallëzojë atë që mendon. Askush tjetër nuk ka status më të lartë, asnjë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, pavarësisht çfarë është, i majtë apo i djathtë.

Fjalën e ka zoti Ndreu.

Pjerin Ndreu – Meqenëse jam pjesë e organeve ligjzbatuese, ky komision nuk është sallë gjyqi. Kujt keni ardhur t'i bëni ligjin? Ky është Komisioni i Ekonomisë, që flet për terma ekonomike dhe jo për arrestime.

E dyta, me vjen shumë keq që si deputetë, mirë se nuk dini, por as nuk pyesni. Lërja Flamurit ato interpretime, zonjë, se i di më mirë, Aldo i di, se është jurist, kurse ti dukesh që nuk ia ke haberin.

Erion Braçe – Zoti Ndreu, ju lutem shumë, kam edhe për ju të njëjtën thirrje që i bëra zonjës në fjalë. Nuk ka tagër asnjë në komision që të japë vlerësime për kolegun e vet. Nëse doni të flisni për çështjen, flisni!

Pjerin Ndreu – Unë nuk flas për ekonominë, por do të këtë që di. Unë i sugjerova, nuk e ofendova, i thashë që nuk ka haber për këtë punë dhe kjo është e dukshme. Të burgosurit kanë të drejtën e jetës, e fjalës, e kallëzimit, pra të gjitha të drejtat, por kanë lirinë e kufizuar, kështu që edhe kur është në burg ka të drejtë të denoncojë. Pyetja juaj si ka mundësi që denoncon njëri, i cili është i penalizuar, një deputet apo këdo, është pyetje pa sens

dhe nuk i takon askujt me njohuri minimale, me shkolle të mesme e jo më një deputeti. Moderoni gjërat, se keni marrë vrull për të nxirë gjithçka! Mundohuni të mos flisni budallallëqe, se nuk është mirë!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Ndreu!

Fjalën e ka zoti Noka.

Flamur Noka - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Unë e kuptoj dëshirën dhe predispozitën, madje e kuptoj edhe makthin që ju ka pllakosur si maxhorancë prej 2 javësh dhe që po e përjetoni *non stop*. E kuptoj se ky makth dhe ky panik ju detyron të bëni gjoja se po studioni dhe po shqyrtoni ligje në normalitet. Keni sjellë ligjin “Për lirim të frekuencave të dixhital-dividentit” dhe kërkon t’ua impononi qytetarëve të këtij vendi si prioriteti absolut i ditëve të sotme. Në fakt, jo vetëm ne si opozitë, por edhe qytetarët, më prioritet se ligjin “Për lirim të frekuencave të dixhital-dividentit” kanë lirim të Ministrisë së Brendshme nga kthetrat e krimit dhe të trafikut të drogës. E thashë radhën e kaluar dhe po e përsëris: është e papranueshme të poshtërohet kaq rëndë Shqipëria, vendi ynë i dashur, nga “Rilindja” dhe Kryeministri i saj. Është e papranueshme që t’u thuash shqiptarëve dhe t’i thuash Europës, tek e cila po vrapojnë të trokasën në derë, se në Shqipëri nuk ka më asnjë individ normal, që mund ta kandidojë dhe të zgjidhet si ministër i Brendshëm. Pse? Sepse sipas Kryeministrit, këtu të gjithë u marrkan me drogë. Si mund të fyesh popullin tënd dhe t’i thuash: “Juve, që më votuat për dy mandate resht, me shpresën për ta bërë më të mirë këtë vend, po jua kthej besimin, duke emëruar dy herë si ministra të Brendshëm njerëz të lidhur kokë e këmbë me drogën dhe me trafikun e drogës”, pra me krimin e organizuar. Dhe ku? Pikërisht në institucionin, i cili, siç ia jep tagrin edhe ligji, edhe Kushtetuta, do të jetë në ballin e luftës kundër krimit, drogës dhe trafikut, që i bie fjala e urtë popullore “T’i varësh ujku mëlçinë në qafë”. Këtë gjë ka bërë maxhoranca juaj, këtë gjë ka bërë Kryeministri juaj.

Vendi ynë nuk mund të mbajë mbi shpinë një barrë të turpshme dhe kaq të rëndë sa të ketë dy ministra resht të lidhur me drogën dhe nga familje mafioze.

Vendi ynë dhe shqiptarët e kanë të pamundur të pranojnë se institucioni i Ministrisë së Brendshme është tapi e trashëgueshme e familjeve mafioze.

Është e papranueshme që prej dy javësh, kur ka plasur skandali i Fatmir dhe Agron Xhafajt, Kryeministri të luajë rolin e strucit, duke futur kokën në rrëzë e duke thënë: “Unë nuk

kam parë asgjë”, ndërkohë që fundshpina i del zbuluar në sytë e të gjithë shqiptarëve dhe ndërkombëtarëve; kjo është e papranueshme!

Kryeministri, në vend që të reagoje me dinjitetin e një shtetari, duke bërë lirim të një ministri të kapur në flagrancë, në përfshirje me trafikun e drogës, bën avokatin e tij. Kjo situatë këtu nuk ka ndodhur në asnjë vend, as të Botës së Tretë, jo më në një vend të Europës, ku ne po shkojmë çdo ditë dhe po trokasim, pavarësisht se shkojmë me atlete apo me këpucë.

Është e papranueshme që, siç mbrojti dikur, dhe shqiptarët janë dëshmitarë dhe kanë memorie, Saimirin, Roshin, Frrokun apo të tjerë, sot, me të njëjtin stil, me të njëjtën mënyrë, me të njëjtin fjalor, me të njëjtën arrogancë, kërkon të mbrojë edhe Fatmirin!

T’ua u paraqesësh si standard normal shqiptarëve dhe europianëve sot, kudo të trokasësh në derë, që mund të emërohet ministër i Brendshëm, pavarësisht se vëllai i tij është i përzier dhe i përfshirë direkt, madje i dënuar me vendim gjykate për trafikim droge, ky nuk mund të jetë standard normal! Kjo është e turpshme për një vend si Shqipëria! Kjo është e turpshme për çdo vend demokratik!

Një demokraci, sado e brishtë të jetë ajo, e ka të pamundur ta pranojë, ndër rregullat e saj, një anomali kaq të rëndë!

Si mund t’i kërkon punonjësit të thjeshtë të policisë, i cili mund të ketë një vëlla, kushëri apo komshi të përfshirë në trafik, ju e përjashtoni nga policia, në një kohë kur keni ministrin me vëllanë të përfshirë në trafik, të kapur në flagrancë, të dënuar me vendim gjykate dhe që i është shmangur drejtësisë?

Nuk është rastësi që vëllai i ministrit tuaj të Brendshëm gjeti momentin për të ikur në Itali, madje mos u mundoni t’ua shisni as ju, as Kryeministri shqiptarëve si një atribut vlerash këtë lëvizje që bëri një i dënuar nga drejtësia italiane! Ajo ishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Ajo ishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Boll tani!

Flamur Noka – Jua sqaroj unë!

Ajo ishte një lëvizje dinake për t’i shpëtuar drejtësisë në Shqipëri. A e dini pse? Sepse ai përgjim ambiental, dhe një tjetër, që do të dalë shumë shpejt, do të vërtetojë se, përveç faktit që vëllai i ministrit të Brendshëm ka qenë dikur i përfshirë në trafik droge, për të cilin

ka një vendim gjykatë dhe është i dënuar, ka vazhduar të jetë aktiv duke pasur mbrojtjen e vëllait, ministër i Brendshëm.

Në bazë të ligjeve shqiptare dhe në bazë të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, zotërinë, Agron ose Geron Xhafaj, duhej ta kapte, ta përfshinte ligji i antimafras, në bazë të të cilit duhej që të gjitha pasuritë që i hetohen t'i sekuestrohen jo vetëm zotit Agron Xhafaj, por edhe familjarëve të tij, pra edhe ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj.

A mund të më thoni, zotërinj, ku ekziston një vend në Europën e qytetëruar, madje po ju them edhe në Botën e Tretë, ku ministri i Brendshëm të thotë: “Po, mua teorikisht më kap ligji i antimafras, por praktikisht jo”?! A mund të ma shpjegoni çfarë do të thotë kjo? Çfarë është kjo? Kjo është një arrogancë, e cila buron nga numri i votave të blera, të vjedhura dhe të marra nga kthetrat e krimit! Kjo është një arrogancë karshi qytetarëve shqiptarë! Kjo është një arrogancë e pashembullt karshi shqiptarëve dhe Europës! Por ne nuk mund të heshtim, sepse, ndryshe nga qeveria, ndryshe nga Kryeministri, ndryshe nga maxhoranca, që sot, siç e thashë edhe radhën e kaluar, nuk mund t'i përfaqësojë më votat e qytetarëve shqiptarë, por do të përfaqësojë votat e baronëve të krimit, të drogës, pasi kjo maxhorancë dhe ky Kryeministër përfaqësojnë votat e Habilajve, votat e Balilit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, votat e Shullazit! Po, po, votat e të gjitha bandave të Shqipërisë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo maxhorancë dhe ky Kryeministër nuk përfaqësojnë më sot votën e asnjë qytetari të ndershëm dhe dinjitoz të Shqipërisë, por përfaqëson votën e Agron Xhafajt dhe të ushtarëve të bandave të tij! Kjo maxhorancë dhe ky Kryeministër përfaqësojnë votën e trafikantëve të drogës, votën e hashashit dhe të kokainës!

Si mund t'i paraqisni ju problemet? Një ministër i Brendshëm, që e shndërroi vendin, nga një vend i hashashit, në një vend të trafikut të kokainës!

Si mund të rrijë në këmbë një pushtet, i bazuar në këto antivlera të një shoqërie? Po ju pyes: a ka ndonjë vend demokratik, ku Kryeministri merr hapur dhe publikisht rolin e prokurorit të Përgjithshëm? Ju keni abuzuar vazhdimisht dhe keni dhënë thjesht akuza.

E dëgjuat çfarë tha sapo u kthye nga Franca? Pa u bërë 15 orë nga momenti që deputetët e opozitës i dorëzuan kasetën e audiopërgjimit organit të prokurorisë, Kryeministri, duke marrë tagrin e prokurorit, ekspertit dhe prokurorisë, pasi e kishte dëgjuar audiopërgjimin ambiental dhe e kishte dërguar atë për ekspertizë në një institucion shumë të specializuar, tha që ishte fals.

Mund të më thotë ndonjëri prej jush se çfarë lidhje ka Kryeministri me një material të sekuestruar nga prokuroria? Çfarë lidhje mund të ketë pushteti ekzekutiv me një material që është në dorë të pushtetit gjyqësor? Kush mund të ma thotë?

Kjo tregon, që, në ngutje e sipër për të mbrojtur Fatmir Xhafajn, të kapur në flagrancë për kokainë, Kryeministri tregoi që është edhe kryeprokuror. Pasi e këshilluan se ajo që bëri ishte një gafë e rëndë publike, filloi t'i dredhoj asaj deklaratë. Shqiptarët nuk mund të durojnë më. Ju bëj me dije se keni dëgjuar një audiopërgjim autentik, që vërteton se ministri i Brendshëm është mburoja politike e të vëllait të tij të dënuar për trafik droge.

Do të dalë material tjetër, që do të vërtetojë katërçipërisht se gjatë kohës që ministër i Brendshëm është Fatmir Xhafaj, vëllai i tij ka qenë shumë aktiv në trafikun e drogës. Kjo ditë do të tregojë pse iku me aq nxitim në Itali Agron Xhafaj, por për maxhorancën dhe Kryeministrin do të jetë pak vonë, sepse, siç e thashë, dita për të treguar që është një shtetar i denjë ishte kur u kthye nga Franca dhe të lironte nga detyra ministrin e Brendshëm. Ditën e shtunë qytetarët shqiptarë do ta lirojnë nga detyra ministrin e Brendshëm pa pasur nevojë për mbështetjen tuaj apo atë të Kryeministrit. Në rast se nuk e lirojnë ditën e shtunë, bëhuni gati se do të liroheni ju bashkë me ministrin tuaj.

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Noka, kërcënimet në një demokraci kushtetuese, siç ju bëtë deri tani, janë të tepërta. Në referencë të ligjit, kërcënimet në një demokraci kushtetuese quhen faj i rëndë. Në qoftë se ju mendoni se do ta merrni pushtetin me dhunë, siç e morët në 26 maj të vitit 1996, pa asnjë lloj problemi, ne këtu jemi, bujrum merreni. Këtë gjë e keni provuar edhe dy vjet pas vitit '96. E keni marrë pushtetin me dhunë për disa orë dhe e keni lënë qetësisht duke ikur në shtëpitë tuaja.

Flamur Noka – Ajo që unë ju thashë, që të mos keqkuptohemi, ...

Erion Braçe – Zoti Noka, tani e kam fjalën unë.

Flamur Noka – Unë ju thashë që po mbani me dhunën e kartonëve në karrigen e ministrit një njeri, i cili rrjedh nga një familje mafioze e përfshirë dhe e kapur në trafikun e drogës.

Erion Braçe – Ky është opinioni juaj.

Flamur Noka – Unë ju thashë që ne si opozitë ju paralajmëruam të respektoni rregullat, ligjet dhe Kushtetutën e këtij vendi, pasi, në të kundërt, me këtë arrogancë që po u drejtoheni sot shqiptarëve dhe që po përpiqeni të qeverisni, shumë shpejt do të thyeni qafën. Më besoni, po që se nuk reflektoni, ajo ditë do të vij shumë shpejt.

Erion Braçe – Kjo që thatë tani është tjetër gjë.

Flamur Noka - Është e njëjta gjë.

Erion Braçe – Kjo lidhet me statusin fizik dhe jo pushtetin, sepse thatë “thyerje qafe”.

Ju them edhe një herë tjetër se në të gjithë ligjërimin tuaj, që unë e quaj propagandistik, ka një problem shumë të madh.

E para, jeni totalisht kundër Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga germa “a” deri te marrja e pushtetit me dhunë. Pa asnjë diskutim që jeni në të drejtën tuaj të silleni edhe kështu, por mua më takon t’ju them këtë gjë.

E dyta, kur flasim për krime të konsumuara, duhet të kini parasysh se që prej vitit 1990 jetojmë në një sistem demokratik. Krime kolektive në demokraci nuk ka. Krimi është individual. Para viteve ‘90 kishte krime kolektive. Kështu i konsideronte ajo parti në atë kohë, ashtu i jetonte dhe i gjykonte ai regjim në atë kohë dhe ashtu i jepte edhe zgjidhje. Në regjimin që ne kemi zgjedhur të jetojmë krimi është individual dhe ka edhe një parim, që është garant, jo për atë që akuzon, por për atë që akuzohet: Mbrohet edhe ai që akuzohet. Nuk i jepet e drejta atij që akuzon.

Flamur Noka - Zoti kryetar i komisionit, ...

Erion Braçe – Zoti Noka, unë ju dëgjova, tani ju lutem më lini të flas.

Flamur Noka - Kur foli zonja Tabaku ju thashë që jeni drejtues i këtij komisioni ...

Erion Braçe – Patjetër që do flas, zoti Noka.

Flamur Noka – Jo, pra.

Erion Braçe – Nuk funksionon kështu.

Flamur Noka – Ju keni të drejtë të flisni, ashtu siç edhe ne, por nuk ekziston e drejta që ju të flisni pas çdo folësi. Ju nuk jeni komentator, por drejtues komisioni. Vazhdoni rolin e drejtuesit të komisionit dhe jo të komentatorit.

Erion Braçe – Zoti Noka, në qoftë se ju flisni 12 minuta dhe nga ato 10 minuta më drejtoheni vetëm mua, pa diskutim që unë do ju përgjigjem.

Flamur Noka – Zotëri, fjalët e mia mund t’i komentojnë qytetarët, por jo ju. Ju jeni drejtues komisioni, jepni fjalën, menaxhoni mbledhjen, por nuk jeni komentator.

Erion Braçe – Nuk është kështu, zoti Noka. Kush ta ka thënë këtë? Kuvendi ka Rregullore. Unë këtu jap mendimin tim, nuk komentoj gjë.

Flamur Noka – Rregullorja nuk e njeh të drejtën e komentatorit.

Erion Braçe - Po thosha që në këtë sistem ku kemi hyrë, ai që akuzohet mbrohet me Kushtetutë dhe prezumohet i pafajshëm deri në sekondën e fundit. Më vjen keq, por, pikërisht këtë që po ju them unë....

Flamur Noka – Zotëri, për çfarë mbrojtjeje po flet kur zotëria ka marrë vendim të formës së prerë nga Gjykata e Kasacionit? Çfarë mbrojtje do t'i bësh kur procesi i mbrojtjes ka përfunduar. Ajo që ju po bëni është mbrojtje politike e krimit dhe drogës.

Erion Braçe – Zoti Noka, ju akuzoni ministrin e Brendshëm si të përfshirë në trafikun e drogës, duke filluar ...

Flamur Noka - ... ministri i Brendshëm suport politik.

Erion Braçe – A ka mundësi ta mbaroj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi ta mbaroj?

Flamur Noka – Mos më vendos në gojë fjalë, që unë nuk i thashë! Unë thashë se ministri ishte duke mbrojtur dhe duke suportuar të vëllain.

Sot do ta shihni!

Erion Braçe – Zoti Noka,

Flamur Noka – Sot do ta shihni!

Erion Braçe – Po.

Zoti Noka,

Ky për të cilin po shpreheni, është një faj shumë i rëndë. Ministri i Brendshëm paska mbrojtur vëllain në një aktivitet kriminal. Ky është shpërdorim i pastër detyre, përfshirje në krim dhe çfarë të doni ju. Klasifikojeni në sa nene të doni.

Flamur Noka –Thojani Kryeministrit këtë që më thatë mua!

Erion Braçe – Po.

Nëse ju pretendoni që kjo ka ndodhur, pa asnjë lloj diskutimi, ju jeni në dijeni të një akti kriminal të konsumuar, të një krimi të konsumuar dhe që nga ky moment duhet t'i drejtoheni, unë po jua sugjeroj modestisht që është e kotë të rrini këtu dhe të dëgjoni zotërinjtë, që do të flasin për çështjen për të cilën i kemi thirrur.

Ju duhet të nxitoni dhe të kallëzoni në prokurori pikërisht këtë fakt. Deri tani ...

Flamur Noka – Kallëzimi në prokurori është bërë.

Erion Braçe – Zoti Noka,

Deri tani nuk keni bërë asnjë gjë nga këto që po thoni. Më vjen keq!

Në prokurori nuk ka asnjë kallëzim nga ju. Prokuroria e ka filluar çështjen, ndërkohë që tjetërkush ka bërë një kallëzim ndaj jush. Kështu, nëse jeni në dijeni të këtij krimi, që qenka kaq monstruoz sa thoni ju, të mos konsumojmë këtu një mbledhje të Frontit të para viteve '90. Ta lëmë këtë histori: jo vëllai, jo tezja, jo gjyshja e të tjerët me radhë.

Të shkojmë në ato institucione dhe le të kallëzojmë krimin. Të mos kthehemi 100 vjet prapa. Tani s'kemi pse të merremi me këtë histori dhe s'kemi pse të konsumojmë as gjyqe popullore, as gjyqe politike. Le ta konsumojmë me ato mundësi që na ka krijuar Kushtetuta, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, të shkojmë atje dhe ta denoncojmë.

Në të kundërt, nëse hyjmë në këtë lloj marrëdhënieje, jua them unë, zoti Noka. Ju nuk keni qenë asnjë ditë në Lazarat si ministër i Brendshëm, por një paraardhësi juaj ka qenë në Lazarat, mu në mes të plantacionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më vjen keq!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ka lidhje. Si nuk ka lidhje?

Ka lidhje që ç'ke me të.

Flamur Noka – Kjo është qesharake dhe a e dini pse?

Erion Braçe –Më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Noka,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Zoti Noka,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flamur Noka – Këtë vetëm Rilindja mund ta bëjë. Po ju them se ka një ndryshim esencial.

Erion Braçe – Fare, zero.

Flamur Noka –Në moralin e kësaj shoqërie dhe në moralin e opozitës është e papranueshme të jetë ministër i Brendshëm një njeri, që ka vëllanë trafikant droge të dënuar dhe të kapur në flagrancë me një audio apo me një video përgjim duke bërë trafik droge, nën pushtetin e të vëllait ministër. Ky është një problem, që e kapërcen moralin e çdo shoqërie demokratike. Gjëra të tilla ndodhin vetëm në diktaturë, ku familjarët e diktatorit kanë të drejtë të vrasin, të presin, të bëjnë trafikë, të bëjnë ç'të duan dhe të mos u hyjë gjemb në këmbë.

Në demokraci kjo nuk mund të pranohet. Ju e keni pranuar dhe a e dini pse e keni pranuar? Sepse të gjitha mandatet tuaja janë prodhim i kategorisë Agron Xhafaj, Balilaj, Habilaj etj.

Të gjitha mandatet tuaja janë prodhim i parave të drogës dhe i bandave kriminale, që sot qeverisin Shqipërinë, të cilat ju kanë kapur për fyti. Ndoshta jo ju individualisht, por pushtetin tuaj, Kryeministrin tuaj, ministrin tuaj të Brendshëm, qeverinë tuaj e kanë kapur për fyti.

A e dini se Kryeministri juaj nuk mund të emërojë sot asnjë titullar të niveleve të larta, pa marrë pëlqimin e bandave?

A e dini se Shqipëria është sot i vetmi vend ku bandat ndajnë tepsinë? Drejtorinë filan e ka kjo bandë. Kryeministri u lutet bandave të tjera t'i kërkojnë një drejtor tjetër. Drejtorinë filan e merr një tjetër bandë e kështu me radhë.

A qeverisin shqiptarët? Jo.

Më shumë se t'ju kapi me presh në dorë, opozita nuk ka se çfarë të bëjë.

Në rast se ju nuk reagoni, në rast se Kryeministri juaj do të luajë rolin e strucit, duke e futur kokën në rrërë, ndërkohë që fundshpina i ka mbetur zbuluar dhe po qelb dynjanë, atëherë do të ketë një reagim popullor.

Erion Braçe – Zoti Noka,

Unë e kuptoj ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj, se nuk po më lini ta mbaroj fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, do të flas aq sa më lejon Rregullorja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm ju po flisni.

Zoti Noka,

Pa asnjë diskutim që gjithë sa thoni ju, në rast se përbën krim, duhet dorëzuar në prokurori. Kjo është rruga më legale, më e ligjshme që ka ky sistem që nga viti 1990 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flamur Noka –Ti po më thua të denoncoj Edi Ramën, tek Edi Rama?

Këtë po më thua?

Erion Braçe – Patjetër, edhe këtë mund ta bësh.

Pra, zoti Noka, unë e kuptoj që të hysh në një fshat dhe të flasësh me dikë atje, nuk përbën krim, por të marrësh vendim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Flamur Noka –Të shkojë në një fshat është detyrë e ministrit.

Erion Braçe – A ka mundësi ta mbaroj?

Pra, të hysh në një fshat dhe të flasësh në cilësinë e ministrin e Brendshëm, të bësh mbledhje dhe të mos e godasësh krimin, që e ke rreth e qark atje, pa asnjë diskutim që është një shpërdorim i pastër i detyrës, por unë e mirëkuptoj vetëm në një aspekt: për sa kohë që në krye të tij ishte një kryeministër, i cili del publikisht në televizion dhe thotë se ky ishte një vendim politik, që atje të mbillej dhe të kultivohej drogë dhe jashtë tij të mos kishte, pa asnjë lloj diskutimi, që ky është krim.

Që nuk kishte dhe nuk ka prokurori që ta hetojë këtë gjë, këtë e kuptojmë. Kjo është fare e evidente, është faqja e dytë e të gjithëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishit 5 vjet thotë, ta hetonit. Ta hetonim me prokurorin e zonjës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ti e zgjodhe. E kam thënë edhe një herë tjetër: vetëm unë dhe Jozefina Topalli kemi votuar kundër tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm ne të dy. Vetëm unë dhe zonja Topalli kemi votuar kundër tij dhe një morie gjykatësish, të cilët po ikin tani me tuta në fundshpinë.

Dakord?

Kështu, po jua përsëris edhe një herë: për këtë histori duhet t'u adresoheni autoriteteve ligjzbatuese.

Tani e kam me ju, zoti Noka. Ju lutem, mbani një standard!

Unë e kuptoj fare mirë që ju e keni me Kryeministrin dhe thoni pse ai tha se ka bërë ekspertizën e tij, ndërkohë që organet ligjzbatuese të shtetit duhet të bëjnë detyrën ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi ta mbaroj? Një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga televizori, zonjë. Na e dha televizori filmin, që kishit bërë.

Flamur Noka – Bëre një ndërhyrje qëparë, ndërsa tani ndërhyre në një fushë të huaj, sepse është jashtë kompetencave të tua. Nuk merret kurrë prova për të bërë ekspertizën nga televizioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prano që Kryeministri ka marrë prova të rreme dhe vazhdojmë.

Erion Braçe – Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi ta mbaroj, zoti Ndreu?

Zoti Noka,

Edhe një herë. Pa asnjë diskutim, unë e pranoj që është provë e rreme, **në qoftë se email-i** i dërguar nga Partia Demokratike pa asnjë diskutim është **provë nga Rama**. Është e qartë, e para.

E dyta, që është shumë e rëndësishme, po ju thosha të mbani një standard, sepse në një rast të ngjashëm, me zë dhe me figurë, jo pasi u kthyen nga Franca, por dy minuta më pas, ish-Kryeministri juaj ka mbajtur një qëndrim shumë më ndryshe sesa ky. Edhe ju keni mbajtur një qëndrim shumë më ndryshe sesa ky.

Flamur Noka – Më falni!

Erion Braçe – Jo, zoti Noka, ju lutem!

Flamur Noka – Jo, mos m'u lut!

Rasti që thua ti, "guri" që ishte në karrigen e ministrit dha dorëheqjen. Rasti që po na tregoni ju "guri" që është në karrigen e ministrit, kapet pas këpucëve të Kryeministrit.

Erion Braçe – Zoti Noka.

Flamur Noka – Ky është standardi.

Erion Braçe – Zoti Noka, një sekondë!

Flamur Noka – Në standardin tonë u dha dorëheqje dhe iu la rrugë të lirë hetimit, në standardin tuaj kapeni pas këpucëve të Kryeministrit.

Erion Braçe – Zoti Noka, ky ishte standardi i ministrit të atëhershëm, zëvendëskryeministrit të atëhershëm, sot President i Republikës, jo juaji. Unë po flas për standardin tuaj.

Flamur Noka – Dha dorëheqjen.

Erion Braçe – Më falni!

Flamur Noka – Dha dorëheqjen dhe tha: “Jam i hapur për drejtësi”, ndërsa sot ky juaji, jo që nuk jep dorëheqje, por lidhet me lidhësen e këpucëve të Kryeministrit, që të mos i shkëputet Kryeministrit dhe nuk jep dorëheqje.

Erion Braçe – Zoti Noka, standardet zakonisht janë individuale. Dorëheqjet, gjithashtu.

Flamur Noka – Janë edhe politike.

Erion Braçe – Një sekondë.

Flamur Noka – Janë edhe politike.

Kemi edhe rastin tjetër, të Rusmailit.

Erion Braçe – Kë?

Flamur Noka – Rastin e Rusmailit, që vëllai i tij vetëm pse po bënte një bisedë miqësore me një titullar, dha dorëheqjen në mënyrë të parevokueshme. Këto janë standardet që kemi vendosur ne. Standardet tuaja janë, siç e thashë, në vend të kollares, lidhësen e këpucëve të Kryeministrit. Këto janë standardet tuaja.

Erion Braçe – Zoti Noka, edhe një herë, rastin Rusmaili ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Noka, rastin Rusmaili ju personalisht mbase mund ta përmendni, njeri tjetër jo, sepse zotin Rusmaili e keni “vrrarë”, apo jo?

Ndërkohë, për rastin tjetër që po më flisni, edhe një herë, është standard individual i zotit Meta. Bravo i qoftë! Edhe në atë periudhë, edhe tani. Por standardi juaj ...

Flamur Noka – Zoti Rusmaili ishte ministër, dha dorëheqjen dhe iku në punë të vet.

Erion Braçe – Zoti Noka, edhe një herë, standardi juaj politik në ligjërime publike, nga Kryeministri, deri te deputeti më i fundit juaji, ishte komplet ndryshe nga ky që po mban sot. Ashtu siç është standard i ndryshëm totalisht gjithë çfarë thoni ju këtu ... Pra, po thoni se trafiku i drogës ...

Flamur Noka – Kam një pyetje.

Gjej ti një ministër të Partisë Demokratike që ka pasur një vëlla të dënuar për trafik droge. E gjen ti një ministër të Partisë Demokratike që është kapur duke suportuar trafikun e drogës me kushërinjtë, që u ka dhënë makinën kushërinjve për të bërë trafik droge? E gjen ti një ministër?

Erion Braçe – Po.

Flamur Noka - Asnjë.

Gjeje një dhe më thuaj!

Erion Braçe – Më lejo ta them!

Po, zoti Noka, ka nga këta dhe sapo ta thashë. Ishte Kryeministri i vendit që kishte marrë vendim, dakord?

Por, po të them edhe një herë tjetër, që, vetëm në dy minuta të ndryshoni standardin këtu, të flisni kundër trafikut të drogës dhe t'i referoheni për trafik droge një njeriu që ka blerë 20 kile hashash dhe e thotë publikisht, e thotë në dëshminë që ju jep juve...

Flamur Noka – Njeriu, që ka qenë i dënuar ...

Erion Braçe – Kjo është ku thërret kiameti.

Flamur Noka – Ai njeri është më dinjitoz se shumë të tjerë këtu, sepse ka pranuar të kryejë dënimin, ndërkohë që ju e keni fshehur.

Erion Braçe – Zoti Noka, për ty ai është shumë dinjitoz, pa asnjë problem, por i dënuar për trafik droge, i dënuar për vjedhje dhe të dalë të thotë se kam blerë vet hashash për këtë histori, që ju e keni lënë në fatin e vet dhe nuk i dilni as për zot, por e keni deleguar...

Flamur Noka – Ai tregoi vetëm ortakun, nuk tha asnjë gjë më shumë. Ai tha: “Ky është ortaku dje dhe ortaku sot”.

Erion Braçe – Zoti Noka, që ai të jetë ortaku duhet ta provojë në mënyrë të qartë në prokurori.

Flamur Noka – Me video dhe me zë.

Erion Braçe – Inshallah.

Flamur Noka – Zërin e dëgjuat, videon do ta shikoni.

Erion Braçe – Audion e dëgjova, kurse tani po pres të shikoj videon. Jam shumë i interesuar të shikoj videon.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Inshallah del videoja!

Pra, edhe një herë ...

Edmond Spaho – Mund të më jepni fjalën?

Erion Braçe – Patjetër.

Pra, ruhuni standardit deri në fund! Mos e diferenconi standardin, sepse është problem shumë i madh për ata që na dëgjojnë, jo për ne. Unë nuk e kam problem. Mbajeni dhe thoni çfarë të doni!

Fjalën e ka zoti Spaho.

Edmond Spaho – Faleminderit!

Mënyra se si po sillesh nuk është korrekte, që pas çdo diskutimi nga ana jonë, ju bëni komente. Ka shumë kolegë që mund ta merrnin fjalën, por, me sa duket, nuk kanë se çfarë argumentesh të thonë. E ndiejnë veten në siklet që nuk mund të flasin.

Është për të ardhur keq që maxhoranca vendos interesat e saj politike, interesat e Partisë Socialiste, mbi interesat e vendit. Është për të ardhur keq që nuk mësoni nga e shkuara, silleni me të njëjtën mënyrë. Me këtë gjuhë keni folur edhe kur ngritëm çështjen e kriminalizimit të Kuvendit: “Nuk kemi deputetë të inkriminuar”, - thatë, dhe më pas nuk kishit çfarë të thoshit as për Arben Ndokën, as për Mark Frrokun. Kështu folët edhe për kryetarët e bashkive. “Nuk kemi, e kemi trim, e ka zgjedhur Kavaja”, - thatë. Më pas doli që Elvis Rroshi kishte aktivitete kriminale në disa vende. Kështu folët edhe për Saimir Tahirin: “Nuk është i fajshëm, nuk ka fare lidhje me Habilajt, shpif opozita”. Tani është në arrest shtëpie. Duhet të ishte në burg, por makinacionet e Edi Ramës dhe kontrolli që i ka vënë prokurorisë dhe gjykatave e bën të jetë me këtë status. Realisht, duhet të ishte në burg sot.

Ne kemi një sfidë, dhe në radhë të parë e keni ju si maxhorancë që qeverisni: sfidën e integritetit europian. Ju kanë vënë dy kushte: luftën ndaj krimit të organizuar dhe ndaj korrupsionit.

Ju mund të qeshni, por Kryeministri juaj, kur shkoi në Bundenstag, nuk qeshi, sepse ia vunë të dyja këmbët në një atlete.

Po ashtu, me këtë gjuhë folën deputetët e parlamentit holandez, në emër të Holandës, që duhet të luftoni krimin e organizuar nëse doni të hapen negociatat.

Me këtë gjuhë ju foli presidenti francez, jua bëri të qartë që nuk ka negociata nëse nuk jepen shenja të qarta të luftës ndaj krimit të organizuar.

Këtë ju thanë në samitin që u zhvillua në Sofje. Lexojeni sot intervistën e reporterit të Bundenstagut, që të shikoni se e keni kusht luftën kundër krimit të organizuar, veçanërisht shtrirjen e tij në qeverisje.

Në radhë të parë, çështja e Fatmir Xhafajt është çështje morale, pastaj është çështje juridike. Nuk po kërkojmë as të bëjmë prokurorin, as gjykatësin. Mjafton fakti që vëllai i tij është dënuar 7 vjet burg. Pse është dënuar?! Nuk është dënuar as për vjedhje biçikletash, as për vepra të tjera ordinere, por është dënuar për krijim të organizatave kriminale dhe transport ndërkombëtar droge. Këto janë dy akuzat më të rënda që mund t’i bëhen dhe ai është vëllai i ministrit të Brendshëm. A mund të rrijë ministri i Brendshëm në këtë pozicion?!

Merrni vetëm raportin e tij me ligjin antimafia, meqenëse thoni se çfarë ligjesh keni! A është në gjendje ky ministër tani të sekuestrojë pasurinë e të vëllait?! Se duhet ta

sekuestrojë, për shkak se është dënua për krijim të organizatave kriminale dhe transport ndërkombëtar droge. A është në gjendje t'ia sekuestrojë pasurinë Agronit?! Nga ana tjetër, edhe ai është subjekt i ligjit antimafia. Duhet të kontrollojë dhe të sekuestrojë pasurinë e tij. A e kuptoni në çfarë absurditeti jeni futur?! Nuk mund të rrijë as edhe një orë ministër i Brendshëm. Pa folur për aspektin moral, që nuk gjen ministër në Europë që të jetë në një situatë të tillë dhe të mos japë dorëheqjen. Pse nuk paska Partia Socialiste kandidatë të tjerë për t'i bërë ministër të Brendshëm?! Në çdo rast duhet të jetë dikush që ka lidhje me krimin?! A e kuptoni se në çfarë gjendjeje dhe në çfarë rruge pa krye jeni futur? Duhet të reflektoni, se është në interes të vendit.

“Po ndjekim me vëmendje sjelljen e ministrit Xhafaj”, tha sot reporteri për Shqipërinë në Bundestag. Me copë se kaq ta thotë?! Po presim të japë dorëheqjen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më shumë se kaq doni?!

Erion Braçe – Zoti Spaho, ti të bën që... Po ky reporteri para dy ditësh ta tha copë se nuk dënohet tjetri për familjarin e tij, ti vazhdon tani e tjerr, e tjerr... Boll, more burrë, se e keni kthyer në komunizëm e shkua komunizmit! Po më dukesh si kryetar fronti!

Edmond Spaho – Qëndrimi juaj është i diktuar nga Kryeministri Rama. Ai nuk është se do të mbrojë Xhafajn, as Tahirin, se për ta nuk i bie ndër mend, sepse tërë jetën nuk ka mbajtur ndonjë shok që ta ketë mbrojtur. Ata mbrojnë veten e tyre, prandaj filloi me akrobaci të tilla dhe tha: “Ja kam bërë analizën përgjimit” dhe brenda 4 orëve nxori që qenka i sajuar, qenka fals! Sot, kur e pyesim se ku e bëri ekspertizën, nuk di ta thotë, por thotë: “Po pres konkluzionet e prokurorisë”. Të cilës prokurori? Të asaj, të cilën e kontrollon nga maja deri në fund?! Po ju bëjmë thirrje përditë që t’ju ndërgjegjësojmë, sepse kjo është një histori me një fund që i dihet. Fatmir Xhafaj duhet të japë dorëheqjen, në mënyrë që të plotësoni qoftë edhe një minimum kushtesh që vendit t’i hapen negociatat. Nuk të pranon njeri në Europë më një ministër të Brendshëm të tillë.

Na keni pasur këtu javën e shkua, na keni sot këtu, do të na keni nesër, pasnesër. Do të vazhdojmë të ushtrojmë të gjithë presionin e mundshëm. Kaq ka në dorë opozita: të drejtën e fjalës, pra që t’ju bindim se ky zotëria duhet të japë dorëheqjen. Kjo është gjëja e parë që duhet të bëjë. Pastaj është detyrë e institucioneve të shikojnë implikimin e tij juridik, pra sa dhe si i ka dhënë mbështetje vëllait të tij. Në radhë të parë, ai duhet ta japë moralisht dorëheqjen, sepse nuk mund të rrijë në pozicionin e ministrit të Brendshëm. Ne do të vazhdojmë t’ju bëjmë këtë presion. Dëgjoni apo jo, të fundit kemi protestën. Do ta shikoni të

shtunën se çfarë do të thotë presion i qytetarëve shqiptarë. Merreni me të qeshur, por do të shikoni se jeni në një gjendje të pashpresë. Jeni pa shpresë! Mos u përpiqni t'i dilni vrullit të qytetarëve me forcë, sepse do ta pësoni ju!

Faleminderit!

Erion Braçe – Zoti Spaho, e di pse qesh unë?! Unë qesh vetëm për një arsye: për kulturën ligjore që ju keni. Nuk funksionon kështu...

Flamur Noka – Kultura ligjore është droga dhe krimi...

Erion Braçe – Pasi të shpall ti fajtor...

Flamur Noka – Të qeverisësh me drogën dhe krimi; të kapesh duke bërë trafik droge?

Erion Braçe – Duhet ta bëjnë këtë gjë institucionet...

Flamur Noka – Kjo është kultura...

Erion Braçe – Nuk funksionon kështu, zoti Noka, pra që të shpall ti fajtor, pastaj duhet ta bëjnë institucionet këtë. Jo, more zotëri, vetëm te kasapi funksionon kështu: e merr, e vë delen atje dhe e ther dhe nuk të gjykon njeri nëse bërë mirë apo keq që e there delen. Në këtë regjimin, të cilin e kemi votuar të gjithë bashkë, veprojnë institucionet, pastaj ju. Kjo historia që vepron dhe të shpall fajtor Partia Demokratike në këtë vend dhe pastaj këtë gjë duhet ta verifikojnë institucionet, nuk ka lidhje as me Kushtetutën e vendit, as me ligjin penal në Shqipëri dhe nuk ka lidhje as me moralin dhe me asgjë tjetër që kemi votuar bashkërisht nga viti 1990 e këtej.

Së dyti, kur Partia Demokratike e Shqipërisë flet për integrimin e vendit, natyrisht që është jo vetëm për të qeshur, por është për të qeshur më zë, pra jo thjesht ta vësh buzën në gaz, por të qeshësh me zë, sepse nëse ka parti në këtë vend që e ka sabotuar në mënyrë kriminale prej pesë vjetësh integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, kjo është Partia Demokratike e Shqipërisë, me Lulzim Bashën në krye të saj, dhe nuk ka parti tjetër në të gjithë historinë 30-vjeçare të këtij vendi që të jetë marrë me këtë gjë. Thagmat që ka bërë Lulzim Basha, natyrisht që janë kthyer në barsleta në çdo parlament të Bashkimit Europian. Të fundit që ishin në Tiranë, të cilët jua thanë qartë, ishin deputetët holandezë, që ju vunë përpara parimin e prezumimit të pafajësisë dhe për një krim individual, jo për një krim kolektiv. Në mënyrë të qartë, para tyre, me zë, me audio, se ka dalë kjo moda e audios tani, jua tha qartësisht deputeti gjerman, raportuesi në Bundestag, se nuk dënohet ministri i Brendshëm për një familjar të tij. Pse?! Sepse në të gjithë botën funksion ligji dhe ligji është ky që po jua themi në mënyrë shumë të qartë.

E fundit, edhe një herë, nuk tremb askënd as Sali Berisha, as Lulzim Basha dhe as të gjithë këta që vijnë këtu me kërcënimin për të dalë më 26 maj. Unë kam hyrë në parlamentin e Shqipërisë nga 26 maji, i bërë copash. Mos rënko fare, ti! I bërë copash më 26 maj, ashtu si ai Xheviti që shikoni atje, ai Roland Xhelilaj që është aty, ky Ismeti që është këtu, si dhe shumë kolegë të tjerë të Partisë Socialiste. Kur ne kemi parë atë me sy, as na bën fare...

(I drejtohet një gazetaresje.)

Dil përjashta ti me syze!

Dil përjashta, që të mësosh se në këtë sallë ka edhe etikë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dil përjashta!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të dilni përjashta!

Shko bëje te PD-ja këtë që po bëje këtu!

Pra, kur ne kemi parë me sy “26 majin” dhe për më tepër kur kemi vuajtur mbi kurriz, në mënyrë të qartë “21 janarin”, as na bën përshtypje fare kërcënimi i PD-së, se me dhunë ditën e shtunë do të hyjë në zyrat e shtetit, do të merret me ne, e ku di unë. Dhunën e kanë në gjak, le ta vazhdojnë dhunën, sepse jam i bindur se do të ikin ashtu siç e meriton gjithkush që ushtron dhunë kundrejt institucioneve jo vetëm këtu, por në të gjithë botën. Kaq.

Kalojmë te çështja për të cilën jemi mbledhur sot.

Fjala për ju, për të bërë prezantimin!

Elton Haxhi – Faleminderit!

Përshëndetje zotërinj deputetë,

Para jush kemi sjellë një ndryshim në ligjin nr. 34/2017, i cili ka lidhje me...

Erion Braçe – Që të jeni të qartë, kur të transmetoni lajmin si zakonisht: ky komision nuk është i bllokuar, por vazhdon punën!

Mund të vazhdoni!

Elton Haxhi – Pra, kemi sjellë një ndryshim në ligjin nr. 34/2017 që ka lidhje me lirim e frekuencave të dixhital-dividentit, i cili ka të bëjë me një saktësim në gjuhën e përdorur në lidhje me kompensimin që parashikohet për operatorët që do të lirojnë frekuencat.

Më konkretisht, ligji në nenin 5, pika 3, ka një kontradiktë në përcaktimin e limiteve të shpërblimit. Nga njëra anë, përcakton një tavan minimal, me një vlerë të përcaktuar

nominalisht, e cila është 5 milionë euro, dhe, nga ana tjetër, përcakton edhe një tavan maksimal, i cili është i shprehur në përqindje mbi vlerën e shitjes së frekuencave.

Kjo në vetvete do të krijojë, nëse do të zbatohet, një konfuzion në përcaktimin e shumës, sidomos në rastin nëse shitja e frekuencave do të jetë çdo vlerë nën 50 milionë, e cila sjell minimumin 5 milionë, që është më i lartë sesa 10% e vlerës.

Për ta bërë të zbatueshëm dhe për të mënjeluar çdo keqinterpretim në zbatimin e këtij ligji, është propozuar që ky paragraf, pra kjo pikë e nenit 5, të riparaqitet edhe një herë me një përcaktim vetëm për tavanin minimal, i cili është 5 milionë euro dhe të hiqet tavanin maksimal 10%. Vetëm ky është ndryshimi dhe qëllimi i këtij amendimi.

Erion Braçe - Keni ndonjë shpjegim tjetër?

Zoti Pëllumbi, urdhëroni!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Në cilësinë e relatorit të Komisionit të Ekonomisë, si komision përgjegjës për paraqitjen e këtij projektligji, e gjej atë në përputhje me nenin 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Propozimi vjen nga Këshilli i Ministrave dhe përbëhet nga dy nene. Ka një ndryshim fare të thjeshtë, sepse ka një mospërputhje në rast se do të zbatohet, siç është aprovuar, midis tavanit dhe dyshemesë. Pra, dyshemeja është vendosur në vlerë absolute, kurse tavanin në vlerë relative. Rrjedhimisht, mospërputhja e të dyjave mund të sjellë një nonsens në aplikimin e tij nesër.

Duke qenë se ky projektligj ka pasur edhe një obligim ndaj operatorëve, të cilët do të lëshojnë këto frekuenca, atëherë kemi një detyrim ndaj tyre për ta plotësuar. Kështu që propozimin e sjellë nga Këshilli i Ministrave e gjej me vend dhe i ftoj kolegët ta aprovojmë.

Erion Braçe - Ka pyetje nga kolegët?

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.34/2017 “Për lirimimin e frekuencave të dixhital-dividentit”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në votim projektligjin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Ndjesë për debatin politik, por është jashtë mundësive tona dhe, siç e shihni, është i imponuar.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA